

NJOFTIM
Për fillimin e aplikimeve për bursë

Për studentët e ciklit të parë Bachelor dhe studentët e programeve profesionale
Viti Akademik 2025–2026

Në zbatim të VKM nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar me VKM nr. 39, datë 23.01.2019, studentët aplikojnë për bursë sipas kategorive të mëposhtme dhe dokumentacionit përkatës:

LISTA E DOKUMENTACIONIT SIPAS KATEGORIVE

A. Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike

1. Kërkesë me shkrim për t’u trajtuar me bursë.
2. Vërtetim që familja trajtohet me ndihmë ekonomike, ku specifikohet numri i dosjes, masa e ndihmës, si dhe datat e fillimit dhe përfundimit (me firmë dhe vulë origjinale).
3. Fotokopje e kartës së identitetit.
4. Çertifikatë familjare (e-albania).

B. Bashkëshortë me fëmijë, ku të dy janë studentw, pwrfitojnw secili bursw

1. Kërkesë për bursë.
2. Fotokopje e kartës së identitetit.
3. Vërtetim studenti për secilin bashkëshort.
4. Çertifikatë familjare (e-albania).

C. Studentë me aftësi të kufizuara, të vërtetuara nga KMCAP

1. Kërkesë me shkrim për bursë.
2. Çertifikatë familjare (e-albania).
3. Fotokopje e kartës së identitetit.
4. Vërtetim nga KMCAP (origjinal ose kopje e noterizuar).
5. Vërtetim nga ISSH ose nga njësia vendore për pagesën e aftësisë së kufizuar.

Ç. Studentë që i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara

1. Kërkesë për bursë.
2. Vërtetim nga KMCAP për të dy prindërit.
3. Vërtetim nga ISSH/njësia vendore për pagesën e aftësisë së kufizuar.
4. Çertifikatë familjare (e-albania).
5. Fotokopje e kartës së identitetit.

D. Studentë që i kanë të dy prindërit pensionistë

1. Kërkesë për bursë.
2. Çertifikatë familjare.
3. Fotokopje e kartës së identitetit.
4. Vërtetim nga ISSH me specifikimin e masës së pensionit.

D/a. Studentë që kanë një prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton

1. Kërkesë për bursë.
2. Çertifikatë familjare.
3. Vërtetim nga ISSH për pensionin e prindit.
4. Fotokopje e kartës së identitetit.
5. Çertifikatë vdekjeje.
6. Vërtetim nga ISSH për prindin pensionist me specifikimin e masës së pensionit.
7. Vërtetim nga zyra e punës që prindi jetues është i papunë.

DH. Studentët e tretë në radhën e fëmijëve, në familje me tre fëmijë e më shumë

1. Kërkesë për bursë.
2. Çertifikatë familjare.
3. Fotokopje e kartës së identitetit.
4. Vërtetim nga fakultetet përkatëse që dy fëmijët e parë janë studentë.

E. Studentë me status jetimi (deri në moshën 25 vjeç)

1. Kërkesë me shkrim.
2. Çertifikatë familjare.
3. Fotokopje e kartës së identitetit.
4. Çertifikata e vdekjes së të dy prindërve.
5. Kopje e noterizuar e statusit të jetimit (nga Shërbimi Social Shtetëror).

Ë. Studentë që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë

1. Kërkesë me shkrim.
2. Çertifikatë familjare.
3. Fotokopje e kartës së identitetit.
4. Vendim gjykatë i formës së prerë për humbjen e përgjegjësisë prindërore.

F. Studentë viktimë të trafikut të qenieve njerëzore (me status ligjor, deri 25 vjeç)

1. Kërkesë me shkrim.
2. Çertifikatë familjare.
3. Fotokopje e kartës së identitetit.
4. Vërtetim nga Shërbimi Social Shtetëror për statusin ligjor.

G. Studentë fëmijë të punonjësve të vrarë në krye të detyrës

(Kategoria përfshin: Policinë e Shtetit, Gardën, SHÇBA, Zjarrfikësit, Forcat e Armatosura, SHISH, Policinë e Burgjeve)

1. Kërkesë me shkrim.
2. Çertifikatë familjare.
3. Fotokopje e kartës së identitetit.
4. Çertifikatë vdekjeje e prindit.
5. Vërtetim nga ministria përkatëse për humbjen e jetës në krye të detyrës.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Dokumentacioni duhet të jetë sipas legjislacionit shqiptar, pa korrigjime, origjinal ose i noterizuar, dhe i lëshuar brenda 3 muajve të fundit.
- Studentët nuk përfitojnë bursë ose e humbasin atë nëse:
 1. Ndjekin një program të dytë studimi.
 2. Nuk e përfundojnë programin brenda kohës normale (studentët përsëritës).

DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT

Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i Shkencave Politiko-Juridike dhe Fakulteti i Edukimit:

– Dorëzimi pranë Zyrës së Sektorit Juridik A/139, Godina e dytë e Kampusit Universitar UAMD – Spitallë.

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Fakulteti i Studimeve Profesionale:

– Dorëzimi pranë Zyrës së Sektorit Juridik nr. 214 – Currila.

PAGESA E BURSËS

Bursa financiare paguhet:

- Nga data e regjistrimit (në rastet e aplikimit në fillim të vitit akademik), ose
- Nga muaji pasardhës kur studenti paraqet kërkesën (në rast paraqitjeje gjatë vitit akademik, sipas kriterëve të plotësuar).